VENDIM
Nr. 863, datë 12.11.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS SË KUZUM BABASË", BASHKIA VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i rrugës së Kuzum Babasë", Bashkia Vlorë.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.
3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit "truall", me një vlerë të përgjithshme prej 1 439 196 (një milion e katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 439 196 (një milion e katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Vlorë.
8. Bashkia Vlorë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Vlorë.
10. Bashkia Vlorë, pas miratimit të këtij vendimi, aplikon menjëherë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, e cila brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të vendimit, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Vlorë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Vlorë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE, SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION I RRUGËS SË KUZUM BABASË", BASHKIA VLORË

Nr. rendor	Pronari	Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)								Vlerësimet për shpronësim			Vlera totale (lekë)	Shënime
										Truall				
	Emër/Atësi/Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volum	Faqe	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	Yllka Ibrahim Kokona Bukuroshe Ibrahim Billa Bujar Celo Celai Arben Celo Celai Eglantina Celo Cela Lirije Celo Celai Teuta Celo Celai Avenir Delo Balili Përparim Delo Balili Sokol Delo Balili Ylli Sokrat Pollo Endrit Ylli Pollo Gjergji Ylli Pollo Leta Hasan Bino Krenar Agim Bino Leart Agim Bino Aida Agim Baba Elios Arian Bino	8601	13/105-1	Truall	1800	132	-	40	106	132	10903	1,439,196	1,439,196	
	VLERA TOTALE												**1,439,196**	